



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 10410 Prot

Shkodër, më 27.07.2020


Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni


KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të Shkollës Veterinare)“. Kërkojmë përfshirjen në rendin e ditës meqënëse në shkresën e Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, me lëndë “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020” theksohet që; afati i fundit i lidhjes së kontratës është data 30.09.2020, fondet e akorduara janë të patrashëgueshme për vitin pasardhës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunim,

KRYETAR

Voltana Ademi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2020

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2020

“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I GODINAVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR STREHIM SOCIAL (RIKONSTRUKSIONI I ISH KONVIKTIT TË SHKOLLËS VETERINARE),,

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të, nenit 24 pika 2 ,neni 54 gërma “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore“i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; neni 6 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar; të ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03. 2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 dhe neni 73, pika 2, gërma “dh” të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe Programit buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, të VKB nr 12 datë 26.02.2020 “Për Miratimin në parim të bashkëfinancimit për përshtatjen për strehim social të objekteve ekzistuese në zbatim të fondeve të planifikuara për Programet e Strehimit për Vitin 2020”, në vijim të shkresës së Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, me lëndë “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020”, e administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr.10391 prot. datë 22.07.2020, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të Fondit Rezervë, për zbatimin e projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social për projektin (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)”, nga Programi 4980 fond reserve, në Programin 10661 “Srehimi Social”, art. 231, sipas pakësimeve dhe shtesave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur:

Pakësime:

lekë

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	totali
4980	Fondi Rezerve		Shpenzime të tjera	19,035,000

Shtesa:

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	totali
10661	Srehimi Social	P10661.O2.A4 “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)	Investime	19,035,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Vollgaba Ademi

Zv. Kryetar

Drejtorja e Shërbimeve Sociale Strehimit
dhe Shëndetit Publik

Drejtorja Juridike

Drejtorja e Analizës dhe Programimit
Buxhetor

Drejtorja e Financës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2020

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I GODINAVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE PËR STREHIM SOCIAL (RIKONSTRUKSIONI I ISH KONVIKTIT TË SHKOLLËS VETERINARE),,

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të, nenit 24 pika 2 ,neni 54 gërma “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore“i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; neni 6 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar; të ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03. 2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “, Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 dhe neni 73, pika 2, gërma “dh” të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe Programit buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, të VKB nr 12 datë 26.02.2020 “Për Miratimin në parim të bashkëfinancimit për përshtatjen për strehim social të objekteve ekzistuese në zbatim të fondeve të planifikuara për Programet e Strehimit për Vitin 2020”, në vijim të shkresës së Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, me

lëndë “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020”, e administruar pranë Bashkisë Shkodër me nr.10391 prot. datë 22.07.2020,
sipas relacionit më poshtë:

Bashkia e Shkodrës është shpallur fituese ndër projektet e strehimit për vitin 2020, me projektin “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)”, me vlerë **95,174,998 lekë**. Ky vlerësim është njoftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 604 prot. Datë 15.1.1019, ka shpallur Thirrjen për aplikim për Fondet për strehimin për vitin 2019. Në përgjigje të kësaj shkrese, Bashkia me shkresën nr. 791/1 datë 31. 01.2019 ka dërguar pranë Ministria e Financave dhe Ekonomisë të dhënat e kërkuara, duke filluar menjëherë punën për vlerësimin e nevojave dhe përgatitjen e projektit për aplikim. Në bazë të vlerësimeve, raporteve e kërkesave rezulton se strehimi i grupeve sociale në vështirësi është një nga problematikat kryesore në territorin e Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër synon përmirësimin e situatës aktuale të strehimit. Aktualisht janë 2253 kërkesa në pritje për të përfitur nga programet sociale të strehimit. Mungesa e strehimit vjen si pasojë e një sërë problemesh social-ekonomike, si gjëndja e vështirë ekonomike, papunësia etj.

Për rrjedhojë me shkresën nr. 4054 prot. datë 03.03.2020,, Bashkia e Shkodrës pasi përgatiti projektin, aplikoi për financim për strehim, sipas formatit të aplikimit standart.

Projekti i paraqitur për financim nga Bashkia Shkodër pranë Ministrisë së linjës, i përket programit kombëtar të strehimit “Banesë sociale, me qira, adaptim i objektit ekzistues” dhe adreson problematikën shumë të rëndë të banimit në Bashkinë Shkodër.

Bashkia e Shkodrës ka aplikuar në programin banesa sociale me qera, adaptim i objektit ekzistues, sepse aktualisht objekti i planifikuar ka nevojë emergjente për rikonstruksion. Godina e ish konviktit të shkollës Veterinare është shumë e dëmtuar nga zjarri i rënë, veçanërisht pjesa perendimore e katit +1 të godinës, në të cilën gjysma e çatisë është krejtësisht e dëmtuar dhe godina në këtë pjesë është e zbuluar, duke u bërë rrezik për apartamentet e tjera të katit 0 të godinës. Gjithashtu dëmtimi i plotë nga zjarri i 5 apartamenteve ka sjellë që 5 familje me 28 anëtarë të jenë të pastrehë dhe aktualisht janë të vendosur në konviktin e shkollës së mesme Industriale.

Meqënëse gjatë viteve familjet e akomoduar në këtë godinë kanë kryer shtesa dhe modifikime të objektit, duke sjellë ndryshime strukturore të rëndësishme, rikonstruksioni i godinës sipas projektit parashikon të sjellë një sistemim thelbësor të godinës, hyrjes,

ambjenteve të përbashkëta, hapësirave të brëndshme dhe të jashtme, duke krijuar kushtet bazë të një banese banimi me 28 apartamente.

Projekti parashikon të ndërtohen 28 apartamente duke dhënë mundësi që të shtohen familjet përfituese të tjera në nevojë si dhe të sigurohet limiti prej 5% të përfituesve të jenë familje nga minoriteti Rom dhe Egjiptian.

Këto familje e kanë të pamundur të sigurojnë ambjente të përshtatshme banimi, për këtë arsye është e nevojshme që nëpërmjet programeve sociale të strehimit të përmirësojmë kushtet e tyre të banimit.

Në fund të procesit të adaptimit, në zbatim të detyrimeve ligjore, do të realizohen kontrata me të gjithë familjet, duke shërbyer edhe si model e si eksperiencë për formalizimin e marrëdhënieve me banorët dhe familjet.

Me shkresë nr. 13712 prot. datë 17.7.2020, “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020“, Ministria e Financave dhe Ekonomisë njofton Bashkinë në lidhje me afatet e zbatimit të projektit fitues “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinarë)“.

Gjatë fazës së hartimit të programit afatmesëm buxhetor për vitin 2020-2022, Ministria e Financave akoma nuk kishte bërë me dije nëse do të kishte thirrje për aplikime, si dhe nuk kishte informacion në lidhje me kriteret e aplikimit për financim të projekteve për zbatimin e programeve sociale të strehimit.

Kosto totale e Projektit është 95,174,998 lekë

Bashkë-financimi nga Bashkia Shkodër, është në vlerën e kërkuar **19,035,000** lekë. Ky financim mund të sigurohet nga përdorimi i Fondit Rezervë, i miratuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2020.

Për realizimin e këtij projekti është e nevojshme që të miratohet përdorimi i Fondit Rezervë për zbatimin e projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinarë)“, sipas detajimit në tabelën bashkëngjitur:

Pakësime:

lekë

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	Totali
4980	Fondi Rezerve		Shpenzime të tjera	19.035.000

Shtesa:

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	Totali
10661	Strehimi Social	P10661.O2.A4 “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)	Investime	19,035,000


Pë sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e Projekt-Vendimit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të Shkollës Veterinare)“.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Vebana Ademi


Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Shëndetit Publik



<p>Nr. 05</p>	<p>Projekti: P10661.O2.A4</p> <p>"Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)</p>	<p>Funksioni: 10 Mbrojtja Sociale</p> <p>N/Funksioni: 106 Strehimi Social</p> <p>Llojet e programit: 10661 Strehimi Social</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Strehimi i grupeve sociale në vështirësi është një nga problematikat kryesore në territorin e Bashkisë Shkodër dhe konkretisht krijimi i kushteve, sa më optimale, të banimit mbetet një nga sfidat më të vështira.</p> <p>Bashkia e Shkodrës është shpallur fituese e projektit të strehimit për vitin 2020 me vlerë total 95,174,998 lekë, njoftuar me shkresë nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p> <p>Projekti i paraqitur nga Bashkia Shkodër për financim pranë Ministrisë së linjës, i përket programit të strehimit "Banesë sociale, me qira, rikonstruksion" dhe adreson problematikën shumë të rëndë të banimit në Bashkinë Shkodër të familjeve me probleme social-ekonomike.</p> <p>Bashkia e Shkodrës ka aplikuar në programin banesa sociale me qera, adaptim i objektit ekzistues, sepse aktualisht objekti i planifikuar ka nevojë emergjente për rikonstruksion. Godina e ish konviktit të shkollës Veterinare është shumë e dëmtuar nga zjarri i rënë, veçanërisht pjesa perendimore e katit +1 të godinës në të cilën gjysma e çatisë është krejtësisht e dëmtuar dhe godina në këtë pjesë është e zbuluar duke u bërë rrezik për apartamentet e tjera të katit 0 të godinës. Gjithashtu dëmtimi i plotë nga zjarri i 5 apartamenteve ka sjellë që 5 familje me 28 anëtarë të jenë të pastrehë dhe aktualisht janë të vendosur në konviktin e shkollës së mesme Industriale.</p> <p>Meqënëse gjatë viteve familjet e akomoduar në këtë godinë kanë kryer shtesa dhe modifikime të objektit, duke sjellë ndryshime strukturore të rëndësishme ,rikonstruksioni i godinës sipas projektit parashikon të sjellë një sistemim thelbësor të godinës,hyrjes, ambjenteve të përbashkëta, hapësirave të brendëshme dhe të jashtme, duke krijuar kushtet bazë të një banese banimi me 28 apartamente.</p> <p>Në këtë projekt parashikohet të ndërtohen në total 28 apartamente. Në total parashikohen të strehohen rreth 146 banorë.</p> <p>Kosto totale e Projektit është 95,174,998 lekë</p> <p>Financimi do të realizohet në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 13712/1 prot. datë 17.07.2020, me lëndë "Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020", ndarë sipas viteve 2020 në vlerën 24,117,524 lekë, viti 2021 në vlerën 25, 000,000 lekë dhe viti 2022 në vlerën 27,022,474 lekë.</p> <p>Bashkëfinancimi nga Bashkia Shkodër, sipas kriterëve të Aplikimit është 20% e vlerës totale, 19,035,000 lekë.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të banimit, cilësisë së jetës dhe shëndetit për familjet dhe individë në vështirësi në territorin e Bashkisë Shkodër. • Përmirësimi i situatës social ekonomike të familjeve të pafavorizuara në territor. • Rikualifikim dhe përmirësim i infrastrukturës së zonës ku shtrihet projekti. • Formalizimi i marrëdhënieve me përfituesit duke shërbyer si model dhe eskperiençë për administrimin e objekteve të ngjashme në territorin e Bashkisë Shkodër. • Mbështetja e vazhdueshme e psiko-sociale e përfituesve në fuqizimin e familjes ekonomik dhe social të tyre. 		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p>		
<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja dhe zhvillimi i procesit të prokurimit të punimeve rikonstruktuese të parashikuara në projekt. - Kryerja e punimeve rikonstruktuese të objektit. - Kontraktimi i marrëdhënieve me familjet përfituese të banesave sociale me qira. 		

b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kushte të banimit të përmirësuara për komunitetin që banon në territorin e Bashkisë Shkodër ▪ Cilësi e jetës dhe shëndet i përmirësuar i komunitetit . ▪ Fuqizim social ekonomik i familjeve të pa favorizuara. ▪ Infrastruktura e përmirësuar dhe rikualifikim i zonës ku shtrihet projekti. 							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Familje dhe individë në vështirësi ekonomiko-sociale Komuniteti i lagjes ku zbatohet projekti.			Bashkia Shkodër Ministria Financës dhe Ekonomisë OJF Institucionet publike në territor				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	
A.	"Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksioni i ish konviktit të shkollës veterinare)	19,035,000					19,035,000
	Shuma	19,035,000					19,035,000
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
2020,2021,2022		- Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. - Drejtorja e Studimit Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve - Stafi i Ministrisë që mbulon fushën e strehimit. Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					

VENDIM, UDHEZIM, SHKRESA, KERMESA
NR. 103/P DATE 22.7.2020
DËRGUAR NGA:
LËNDA:



PROSIA E TITULLARIT:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSIMIT E BUXHETIT
DREJTORIA E STREHIMIT

Nr. 13712/Prot.
1

Tiranë, më 17/7/2020

Lënda: Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2020

BASHKISË: Shkodër

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2060, datë 30.01.2020 "Mbi fondet për strehimin për vitin 2020" shtojca A, nëpërmjet së cilës u njoftuan të gjitha bashkitë për hapjen e thirrjes për aplikime me projekte sipas kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës, aplikuan 31 bashki për financimin e 35 projekteve me një vlerë prej 943 milion lekë, nga të cilat 812 milion lekë nga buxheti i shtetit.

Komisioni i vlerësimit të projekteve, pasi shqyrtoi propozimet e dërguara, kualifikoi 24 projekte të 22 bashkive, projektet e të cilave plotësonin kërkesat e përcaktuara në termat e referencës si më poshtë:

- 1- Gramsh, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 2- Devoll, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 3- Vau Dejës, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 4- Selenicë, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 5- Maliq, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 6- Berat, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";
- 7- Vlorë, projekti "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";

- 8- Këlcyrë, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 9- Korçë, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 10- Elbasan, projekti 1 “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 11- Elbasan, projekti 2 “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara (hidroizolim i tarracës së 6 pallateve)”;
- 12- Librazhd, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 13- Patos, projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”;
- 14- Kamëz, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 15- Belsh, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 16- Roskovec, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 17- Kuçovë, projekti 1 “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 18- Shkodër, projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”;
- 19- Pukë, projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”;
- 20- Kolonjë, projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”;
- 21- Pogradec, projekti “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 22- Rrogozhinë, projekti “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”;
- 23- Cërrik, projekti 1 “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;
- 24- Cërrik, projekti 2 “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”.

Në tabelën bashkëlidhur do të gjeni fondet e miratuara për çdo projekt sipas bashkive dhe nivelin e financimit për vitin 2020, 2021 dhe 2022.

Risjellim në vemendjen tuaj se, çdo kursim nga prokurimi do të ndahet sipas përqindjes së bashkëfinancimit dhe fondi i kursyer nga buxheti i shtetit do t'i kthehet Ministrisë.

Në vijim, kërkojmë nga ana juaj që, për një mirëmenaxhim të fondeve, të na informoni çdo muaj, mbi ecurinë e procedurës së prokurimit, lidhjen e kontratave dhe mundësitë për realizimin e fondeve të akordura për vitin 2020. Bazuar në ecurinë e çdo projekti, do të shihet edhe mundësia për të bërë rialokime për bashkitë që kanë ecuri të mirë, duke hequr fondet nga bashkitë që janë më të vonuara dhe mund të mos realizojnë dot fondet e çelura për këtë vit. Bashkitë, të cilat avancojnë me projektet, të bëjnë kërkesë për disbursim të fondeve.

Theksojmë se afati i fundit për lidhjen e kontratës është data 30.09.2020. Fondet e akorduara janë të patrashëgueshme për vitin pasardhës. Nëse bashkia nuk arrin të përdorë fondet e planifikuara për vitin 2020, në vitin 2021 dhe 2022 do të përfitojë vetëm fondet e planifikuara për atë vit.

